



KPM 2023/01

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, pika 6 dhe pika 11, dhe nenit 33 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) dhe nenit 45, paragrafi 8, të Ligjit Nr.06/L-84 për Mbrojtjen e Fëmijës, KPM nxjerr:

**RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË SHËRBIMET MEDIALE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

KAPITULLI I

**Neni 1
Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe moral.
2. Rregullorja përcakton mbrojtjen e fëmijëve gjatë përfshirjes së tyre në përmbajtje mediale, me fokus të veçantë mbrojtjen e fëmijëve të cenueshëm.
3. Rregullorja përcakton mënyrën e kategorizimit, sinjalizimit dhe kohën e transmetimit të programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mendor, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. **Shërbim medial audiovizuel** – shërbim i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i të cilit është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.
2. **Shërbim medial audio** – shërbim i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimit medial audio dhe parimi kryesor i të cilit është ofrimi i programeve me qëllim që të informojë, argëtojë apo edukojë publikun, përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike. Shërbimi medial audio është një radio transmetim, një shërbim medial audio me kërkesë apo komunikim komercial në shërbimet mediale audio.
3. **Ofrues i shërbimit medial** – personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuele të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.

4. **Program** – një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogëve të programeve të vendosur nga ofruesi i shërbimit medial, forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filmat e metrazhit të gjatë, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët, programet për fëmijë dhe dramat origjinale.
5. **Programet e formatit “shfaqje reale televizive”** (“reality show” ose “reality tv”) – nënkupton një zhanër ose format televiziv zakonisht pa një skenar të detajuar, me përmbajtje të realizuara kryesisht në një mjedis natyror ose të krijuar artificialisht në të cilin shfaqet jeta e një grupi pjesëmarrësish në një hapësirë të izoluar, të cilët janë vazhdimisht nën vëzhgimin e video kamerave në një zonë të mbuluar me mikrofone, të cilët në rastin më të shpeshtë janë në konkurrencë me njëri-tjetrin në përpjekje për të fituar një çmim ose përfitime të caktuara pasurore ose jo pasurore.
6. **Program i formatit pseudoreal** – nënkupton një program që tregon situata të caktuara jetësore autentike ose fiktive, fokusi i të cilave është të dramatizimi dhe konfliktet sipas një skenari të paracaktuar.
7. **Përgjegjësia redaktuese** – ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe mjeteve për ushtrimin e kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen dhe organizimin e tyre në radhitje kronologjike në rastin e transmetimit radio televiziv, ose në katalog në rastin e shërbimit medial audiovizuel në bazë të kërkesës.
8. **Transmetim** – emetimi burimor i programit me valë difuzive nëpërmjet transmetuesit tokësor, operatorit të shpërndarjes, transmetimit dixhital, satelitor ose me pajisje të tjera elektronike, të koduar apo të pa koduar, që i destinohen për shfrytëzim publikut që pranohen me radio, televizion ose pajisje elektronike të veçanta për emetim, duke mos përfshirë komunikimet individuale.
9. **Transmetim televiziv (transmetimi linear i shërbimit medial audiovizuel)** – një shërbim medial audiovizuel, i ofruar nga ofruesi i shërbimit medial audiovizuel për shikim të njëkohshëm të programeve në bazë të një orari të programit.
10. **Video sipas kërkesës (Video on Demand – shërbimet e mediave jo lineare audiovizuale)** – një shërbim medial audiovizuel që sigurohet nga ofruesi i shërbimeve mediale për programet pamore në çastin e caktuar nga përdoruesi dhe kërkesa e individit e bazuar në katalogun e programeve të zgjedhura nga ofruesi medial i shërbimeve.
11. **Termi fëmijë** – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.
12. **Termi i mitur** – nënkupton personat që i takojnë moshës prej 14 deri 18 vjeç.
13. **Përfaqësues ligjor** – nënkupton prindin apo kujdestarin, i cili brenda përgjegjësisë që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës.

14. **Dhunë (Transmetimi i programeve që përmbajnë dhunë)** – nënkupton të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit apo forcës. Dhunë përfshin por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo kanos dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përruljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.
15. **Dhunë ndaj fëmijës** – nënkupton çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.
16. **Dhunë fizike** – nënkupton çdo formë të abuzimit fizik duke përfshirë këtu rrahjen me çfarëdo mjete, goditje me shuplakë apo edhe me mjete të tjera, shtrëngimin e fytyrës dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhembje fizike.
17. **Dhunë psikologjike** – nënkupton aktet të cilat shkaktojnë ose kanë mundësi të madhe të shkaktojnë dëm në shëndetin ose në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës. Këto akte mund të jenë në kontrollin e prindit ose të një personi i cili ka përgjegjësi, është i besuar ose ka pushtet dhe përfshijnë kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, trembjen, diskriminimin, përqeshjen, ose forma të tjera jo fizike të armiqësisë ose të trajtimit refuzues.
18. **Neglizhimi i fëmijës** – nënkupton mosveprimin me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.
19. **Abuzimi seksual i fëmijës** – nënkupton shprehjen e abuzimit brenda shtëpisë ose familjes, por nuk përjashton edhe rastet e abuzimit nga persona jashtë familjes duke përdorur përparësitë e pozitës qoftë sociale apo edhe zyrtare për përfitime seksuale nga viktima e abuzimit. Aktiviteti seksual i cili nënkupton marrëdhënie seksuale dhe çdo formë tjetër e kryer nga, me, dhe para fëmijës, ku prania ose pjesëmarrja e fëmijës është për qëllim të kënaqësisë seksuale të personit tjetër.
20. **Fëmijët e cenueshëm** – nënkupton përkufizimet për fëmijët në nevojë për mbrojtje, në rrezik dhe pa përkujdesje prindërore sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.
21. **Fëmijë në nevojë për mbrojtje** – është personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, trafikimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

22. **Fëmijë në rrezik** – nënkupton çdo fëmijë që përjeton një faktor intensiv dhe / ose të vazhdueshëm të rrezikut, ose një kombinim të faktorëve të rrezikut në rrethanat personale, mjedisore dhe/ose relacionale që i pengojnë të ndjekin dhe përmbushin zhvillimin e potencialit të plotë.
23. **Fëmijë pa përkuqdesje prindërore** – nënkupton fëmijën prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilit janë të panjohur ose janë zhdukur, prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror.
24. **Termi kohë e kufizimit** – është koha në orarin radio/televiziv që ndan periudhën e lejueshme për të shfaqur program radio/televiziv, që ka përmbajtje për të rritur prej periudhës kur nuk është e lejueshme. “Koha e kufizimit” fillon prej orës 24:00 dhe mbaron në orën 05:00. Në shërbimet e parapagimit të cilat nuk janë të mbrojtura me kod, koha e kufizimit është po ashtu prej orës 24:00 deri në ora 05:00.
25. **Termi frikë** – nënkupton emocionin, shpesh të fuqishëm, që nxitet nga parashikimi për rrezik, diçka të keqe dhe dhimbje, pavarësisht se kërcënimi është real apo imagjinar.
26. **Termi përmbajtje erotike** – i referohet materialeve programore, që përqendrohen tek dëshira seksuale dhe që paraqesin zona të caktuara erogjene të trupit të njeriut dhe synimin final për akt seksual, edhe në rastet kur nuk paraqiten personat në mënyrë të qartë gjatë marrëdhënieve seksuale.
27. Programet e pikës 27 përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm tek këto përmbajtje:
 - 27.1 Përmbajtjet me dhunë fizike, verbale, jo verbale, emocionale, seksuale ose të përfituara nëpërmjet efekteve speciale. Dhuna e shfaqur në programe të veçanta duhet të vendoset në kontekst të përmbajtjes, të ofrojë mesazhe edukative, të cilat duhet të jenë të kuptueshme lehtë si nga fëmijët, ashtu edhe nga publiku i gjerë. Kjo nënkupton që skenat me dhunë të mos jenë qëllim.
 - 27.2 Përmbajtjet me skena seksuale mund të pasqyrohen në kuadër të programeve shkencore, edukative, dokumentare ose informative. Në këto përmbajtje duhet të shmangen skenat me shfaqje të tilla seksuale si ekzibicionizmi, nudizmi, dhuna seksuale dhe diskriminimi gjinor. Përmbajtjet e tilla vlerësohen në bazë të qëllimit të çdo skene seksuale, duke e vlerësuar përshtatshmërinë e atij qëllimi në raport me moshën e shikuesve.
 - 27.3 Përmbajtja dhe programi me përmbajtje bixhozi, parashikimin e të ardhmes, leximin e letrave dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht.
 - 27.4 Përmbajtjet ku përdoret gjuhë e papërshtatshme, përfshirë gjuhën vulgare, ofenduese, mallkime, sharje, si dhe forma tjera të papërshtatshme të të folurit.
 - 27.5 Përmbajtjet me gjuhë ose sjellje diskriminuese, trajtim të padrejtë ose paragjykes të kategorive të ndryshme të njerëzve, veçanërisht për shkak të

përkatësisë etnike, moshës, gjinisë, aftësisë së kufizuar apo forma tjera diskriminuese.

- 27.6 Përmbajtjet me skena të përdorimit të substancave narkotike, përdorimit të substancave të rrezikshme, përdorimit të armëve, produkteve të duhanit dhe produkteve të alkoolit.
- 27.7 Përmbajtjet apo portretizimet e sjelljeve të rrezikshme, sikurse shembujt në vijim, por duke mos u kufizuar në: përgatitjet për varje, ecjet apo lojërat nëpër shinat e trenit etj, të cilat mund të imitohen lehtësisht nga fëmijët në mënyrë të dëmshme për ta.
28. **Kodi Praktik** – nënkupton dokumentin e hartuar nga Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), me të cilin themelohen mekanizmat vetërregulluese brenda OSHMA-ve, në të cilin parashihen standardet e kategorizimit të përmbajtjeve programore dhe krijimi i një komisioni vlerësues dhe mbikëqyrës për zbatimin e këtyre standardeve.
29. **Termi pornografi** – i referohet përmbajtjeve programore të cilat në mënyrë të qartë dhe të hapur paraqesin organet ose aktin seksual të personave.
30. **Termi programe me përmbajtje të dëmshme** – i referohet programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijëve, përfshirë edhe ato që ndikojnë negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e tyre.
31. **BBFC (British Board of Film Classification)** – përgjegjës për klasifikimin kombëtar të filmave të ekspozuar në kinema dhe video vepra (të tilla si programe televizive, trailera, reklama, informacione publike/filma fushatash, etj.) të publikuara në media brenda Mbretërisë së Bashkuar.
32. **MPA (Motion Picture Association) Film Rating System** – sistemi i vlerësimit të filmave që përdoret në Shtetet e Bashkuara dhe territoret e saj për të vlerësuar përshtatshmërinë e një filmi për audienca të caktuara bazuar në përmbajtjen e tyre.

KAPITULLI II

Neni 3

Kufizimet dhe obligimet e përgjithshme

1. Ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale nuk do të transmetojnë programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, përveçse në kohën dhe kushtet e përcaktuara me këtë Rregullore.
2. Ofruesit e shërbimeve mediale audio të cilët transmetojnë radio programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t'i transmetojnë në kohën e destinuar për të tilla programe dhe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik në fillim dhe pas çdo ndërprerjeje të programit.
3. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale të cilët transmetojnë programe televizive me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë

me sinjal akustik dhe tekstual në fillim dhe pas çdo ndërprerje të programit dhe t'i identifikojnë ato me simbolin përkatës vizuel gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre, sipas kategorizimit të programeve të përcaktuar me këtë Rregullore.

4. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale mund të transmetojnë programe me përmbajtje pornografike vetëm në mënyrë të koduar dhe në pajtueshmëri me nenin 5, paragrafi 2, të kësaj Rregulloreje.
5. Në pajtim me këtë Rregullore, ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale duhet të përcaktojnë standarde vetërregulluese (Kodin Praktik) për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët, si dhe të krijojnë mekanizma të mbikëqyrjes për aplikimin e këtyre standardeve.
6. Pas përpilimit të Kodit Praktik, secili ofrues i shërbimit medial audio dhe audiovizuel do t'i dërgojë një kopje KPM-së jo më vonë se tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje. Ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale mund ta paraqesin Kodin Praktik në mënyrë individuale apo grupore.
7. Me kërkesë të KPM-së, brenda tri (3) ditëve të punës, ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale duhet të paraqesin të dhëna të detajuara mbi implementimin e standardeve vetërregulluese të Kodit Praktik.
8. Me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme programore, rregullat dhe standardet programore të përcaktuara me këtë Rregullore do të jenë të zbatueshme përshtatshëmrisht edhe për kanalet e huaja. Përmbajtjet programore që transmetohen nga kanalet e huaja minimalisht duhet të respektojnë kategorizimet dhe kohën e transmetimit sipas sistemit të vlerësimit MPA, BBFC, e të ngjashme, për sa kohë nuk specifikohet ndryshe me rregullore të KPM-së.
9. Ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale janë të obliguar të paraqesin një sinjalizim në formë vizuale në orën 22:00, për të paralajmëruar kohën e gjumit të fëmijëve.

Neni 4

Mbrojtja e fëmijës nga substancat e dëmshme dhe mjetet e rrezikshme

1. Përmbajtjet programore të cilat promovojnë përdorimin e substancave narkotike, produkteve të duhanit, produkteve toksike, substancave psikotrope, përdorimin e armëve, mjeteve piroteknike, apo substancave të tjera që janë të deklaruara të dëmshme nga autoritetet përkatëse, janë të ndaluara.
2. Përmbajtjet programore të cilat promovojnë përdorimin ose konsumimin e pijeve alkoolike, nuk duhet të transmetohen jashtë kohës së lejuar.

Neni 5

Mbrojtja e identitetit dhe respektimi i dinjitetit të fëmijëve në programe

1. E drejta e fëmijës në zhvillimin fizik, mendor, emocional, edukativ, shëndetësor, social, si dhe mirëqenia e fëmijës, duhet të respektohet dhe mbrohet në masën maksimale të mundshme në përmbajtjet programore të transmetuara nga çdo ofrues i shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.
2. Duhet t'i kushtohet kujdes i duhur dinjitetit dhe integritetit të fëmijëve të cilët janë pjesë ose janë të përfshirë në programe. Ky rregull duhet të zbatohet pavarësisht pëlqimit që jepet nga prindi, kujdestari ose ndonjë person tjetër mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, i cili e përfaqëson fëmijën.
3. Privatësia e fëmijës respektohet në çdo rrethanë gjatë publikimit të tyre në media, pa paraqitur elemente të cilët mund të zbulojnë identitetin e fëmijës, veçanërisht nëse janë duke kaluar nëpër fazat e procedurave gjyqësore apo administrative.
4. Të dhënat për fëmijët, të mbledhura ose të krijuara nga mediat, nuk duhet të përpunohen dhe përdoren për qëllime komerciale.
5. Mediat obligohen të raportojnë në mënyrë etike, duke mbrojtur dinjitetin e fëmijës dhe duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës.
6. Nuk lejohet publikimi i informatave që zbulojnë identitetin e një fëmije të përfshirë në rastet e çfarëdo lloji të dhunës, pavarësisht nga statusi i fëmijës si dëshmitar, viktimë apo kryerës, viktimë e trafikimit, fëmijë i përfshirë në punë të rënda, fëmijë pa kujdes prindëror, fëmijë viktimë e abuzimit me substanca narkotike, fëmijë në konflikt me ligjin apo në rastet e tentativës për vetëvrasje apo vetëvrasjeve dhe as prezantimi i detajeve të çështjeve familjare apo jetës private të fëmijës.
7. Brenda informacionit, identiteti i tyre do të mbrohet gjatë tërë kohës me imazh të hijezuar, të paqartë ose të maskuar dhe me një ton të moduluar, në mënyrë që fëmija të mos identifikohet. Një informacion i tillë nuk do të zbulojë asnjë detaj të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të fëmijëve.
8. Të dhënat personale për fëmijët si dhe detajet e marrëdhënieve familjare dhe jetës private të tyre nuk do të transmetohen në rastet kur transmetimi i informacionit të tillë mund të dëmtojë mirëqenien e tyre.
9. Ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë fëmijëve në përmbajtjet programore, me theks të veçantë fëmijëve të cenueshëm, atyre që janë nën përkujdesje institucionale dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.

10. Obligohen ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale të krijojnë mekanizma të përshtatshme përmes të cilave sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme programore.
11. Ndalohet përfshirja e fëmijëve në programet të cilat mund ta dëmtojnë zhvillimin fizik, moral dhe emocional si dhe në shëndetin dhe mirëqenien e tyre.
12. Në çdo rast të pjesëmarrjes së fëmijës në programe apo intervista, përveç sigurimit të lejes dhe pëlqimit të prindërve apo kujdestarit ligjor, prindërve apo kujdestarit ligjor dhe fëmijëve pjesëmarrës duhet t'iu ofrohen informacione të sakta dhe të kuptueshme për qëllimin e programit.

Neni 6

Programet informative dhe edukative për fëmijët

1. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale kontribuojnë në mënyrë aktive për të promovuar mbrojtjen e fëmijës përmes transmetimit të programeve informative dhe edukative për fëmijët, duke këshilluar fëmijët, prindërit dhe publikun mbi shëndetin, edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve, si dhe mbi ndikimet e mundshme negative që ekspozimi ndaj mediave mund të ketë mbi fëmijën.
2. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale inkurajohen të dedikojnë në oraret e tyre një hapësirë të mbrojtur televizive, në oraret e përshtatshme për fëmijë.

KAPITULLI III

Neni 7

Kategorizimi i programeve

1. **Kategoria e parë** - përfshin programet që nuk kanë përmbajtje të dëmshme dhe janë të përshtatshme për të gjitha moshat.
2. **Kategoria e dytë** - përfshin programet që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën dymbëdhjetë (12) vjeçare dhe për të cilat është e domosdoshme prania e prindit ose kujdestarit. Kjo kategori u referohet programeve, që përmbajnë ndonjë skenë dhune ose skenë që mund të shkaktojë frikë. Rastet kur bëhet portretizimi apo përshkrimi i dhunës dhe pasojave të saj mund të jenë të pranishme në përmbajtjen e programit nëse justifikohet nga objektivi i tij edukativ apo historik. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse.
3. **Kategoria e tretë** - përfshin programet që mund të përmbajnë skena dhune dhe frike, gjuhë të papërshtatshme, nxitje të imitimit të sjelljeve të cilat mund të jenë të dëmshme, si dhe përmbajtje erotike, të cilat përsëriten apo vlerësohen se janë të dëmshme për zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijës. Përmbajtjet me skena seksuale mund të paraqiten në këtë kategori, përveç nëse paraqiten me qëllim të edukimit mbi seksualitetin dhe shëndetin e njeriut. Këto përmbajtje të dëmshme programore nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare. Për programet e

kategorisë së tretë prania e prindit ose kujdestarit është e domosdoshme. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse.

4. **Kategoria e katërt** - përfshin programet që përmbajnë skena me përmbajtje të vazhdueshme dhune, frike, skena seksuale, përmbajtje pornografike, programe me përmbajtje bixhozi, parashikimin e të ardhmes, leximin e letrave dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht. Kjo kategori përfshin edhe përmbajtjet me skena të përdorimit të substancave narkotike, përdorimit të substancave apo mjeteve të rrezikshme, përdorimit të armëve, produkteve të duhanit dhe cigareve elektronike, produkteve të alkoolit, përmbajtjet ku paraqiten sjellje të rrezikshme, përmbajtjet ku përdoret gjuhë e papërshtatshme apo diskriminuese me kusht që në përmbajtjen e programit në tërësi këto nuk paraqiten si sjellje pozitive, pamje të papërshtatshme, të turpshme dhe të pahijshme. Këto programe nuk rekomandohen për persona nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare. Transmetimi i programeve të kësaj kategorie duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse. Ndërsa, programet me përmbajtje pornografike dhe ato me përmbajtje të vazhdueshme frike dhe dhune të cilat mund seriozisht të dëmtojnë zhvillimin fizik, moral dhe emocional, mund të transmetohen vetëm në mënyrë të koduar.
5. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale të koduara nuk iu nënshtrohen kufizimeve kohore të transmetimit.
6. Programet e formatit shfaqje reale televizive (reality show ose reality TV), njoftimet e transmetimit të tyre, si dhe programet që tregojnë pasqyra të ngjarjeve në ato përmbajtje, shënohen me 18+ dhe mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 24:00 deri në ora 06:00. Ky kufizim nuk zbatohet për përmbajtjen e shfaqur me mbrojtje teknike (kodim me pin).
7. Rregullat e përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni vlejnë edhe për kanalet e huaja të cilat shpërndahen përmes operatorëve të shpërndarjes.
8. Programet e formatit pseudorealitet mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 22:00 deri në ora 06:00. Ky kufizim nuk zbatohet për përmbajtjet e shfaqura me mbrojtje teknike (kodim me pin).
9. OSHMA-të dhe OSH-të obligohen të ndërmarrin masat teknike sipas udhëzimeve të KPM-së në rastin e përmbajtjeve me pritshmëri për të dëmtuar zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve.

Neni 8

Koha e transmetimit

1. Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së parë nuk i nënshtrohet kufizimeve kohore.

2. Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së dytë mund të bëhet prej orës 19:00 deri në ora 06:00.
3. Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së tretë mund të bëhet prej orës 22:00 deri në ora 06:00.
4. Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së katërt mund të bëhet prej orës 24:00 deri në orën 06:00.

Neni 9 Shenjat

1. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale obligohen të përdorin të njëjtat shenja të paraqitura në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje.
2. Shenjat e vërejtjes për kategoritë e përcaktuara me këtë nen janë të detyrueshme për të gjitha programet e përcaktuara në nenin 7.
3. Para fillimit dhe pas çdo ndërprerjeje të programit bëhet paralajmërim verbal, tekstual dhe akustik:
 - 3.1 Para fillimit të programit në ekran shfaqet shenja paralajmëruese, e cila është kombinim i vërejtjes tekstuale, verbale, akustike dhe vizuale në kohëzgjatje prej 10 sekondave dhe mbulon të paktën $\frac{1}{4}$ e pjesës së dukshme të ekranit. Formulimi i vërejtjes së shkruar/tekstuale do të jetë: "Programi në vijim nuk është i përshtatshëm për fëmijë."
 - 3.2 Gjatë programit televiziv shfaqet vetëm pjesa vizuale e shenjës në këndin e ekranit, me dimensione minimumi $\frac{1}{48}$ dhe maksimumi $\frac{1}{32}$.
 - 3.3 Programet e Kategorisë së katërt nuk duhet të reklamohen para orës 24:00.
 - 3.4 Skema programore e publikuar në EPG dhe në çfarëdo mjeti të komunikimit me publikun duhet të reflektojë edhe shenjat vizuale për kategorinë përkatëse të programit.

Neni 10 Mekanizmi i mbrojtjes në transmetimin jo linear

1. Procedurat dhe kushtet për kufizimin e lirisë për të ofruar dhe marrë shërbime mediale audiovizuale duhet të jenë të njëjta si për shërbimet lineare ashtu edhe ato jo lineare.
2. Transmetimet jo lineare duhet të ofrojnë Kushtet dhe Termet e Përdorimit të shërbimeve të tyre për përdoruesit, me anë të së cilave bëjnë të ditur natyrën dhe përshtatshmërinë e katalogjeve programore të ofruara.

3. Ofruesit e Shërbimeve Video on Demand do të respektojnë obligimin e kategorizimit të përmbajtjeve programore nga katalogu i tyre sipas moshës, i përcaktuar në nenin 7 të kësaj Rregulloreje.
4. Shenjat e paraqitura në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje duhet të aplikohen edhe nga ofruesit e shërbimeve Video on Demand, duke aplikuar paralajmërim apo përshkrim të shkurtër para fillimit të çdo përmbajtje programore.
5. Ofruesit e shërbimeve mediale jo lineare të cilat transmetojnë programe me përmbajtje pornografike dhe ato me përmbajtje të vazhdueshme frike dhe dhune të cilat mund seriozisht të dëmtojnë zhvillimin fizik, moral dhe emocional duhet të jenë të koduara.
6. Të dhënat personale të fëmijëve të grumbulluara nga qasja në këto shërbime nuk duhet të përdoren për qëllime komerciale, apo në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11
Sanksionet e aplikueshme

Për mosrespektim të kësaj Rregulloreje do të aplikohen sanksionet e përcaktuara me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Neni 12
Dispozitat kalimtare

Me këtë Rregullore shfuqizohet Rregullorja KPM 2013/01.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi në datën e miratimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave





21.12.2023

Datë

KPM 2023/01

SHTOJCA

Kategoria	Vërejtja tekstuale	Shenja
Kategoria 1	Nuk aplikohet.	
Kategoria 2	“Programi në vijim nuk është i përshtatshëm për fëmijë nën moshën 12 vjeçare. Prania dhe këshillimi i prindit/kujdestarit është e domosdoshme.”	
Kategoria 3	“Programi në vijim nuk është i përshtatshëm për fëmijë nën moshën 16 vjeçare. Prania dhe këshillimi i prindit/kujdestarit është e domosdoshme.”	
Kategoria 4	“Programi në vijim nuk është i përshtatshëm për fëmijë dhe të mitur nën moshën 18 vjeçare.”	